



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.438/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B.M.Z. pronar i Barnatores “Palin” me seli në Skenderaj, Rr. “Xhevë dhe Fehmi Lladrovci”, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit me Nr.10/K-67-20 të datës 18.09.2020, jashtë seancës, me datë 27.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HEDHET** padia e paditësit B.M.Z. pronar i Barnatores “Palin” me seli në Skenderaj, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë me seli në Prishtinë , për shkak të anulimit të Vendimit Nr.10/K-67-20 të datës 18.09.2020, **si e paplotësuar.**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi B.M.Z. me datën 21.10.2020 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të Vendimit me Nr.10/K-67-20 të datës 18.09.2020

Gjykata me datë 29.04.2024 ka mbajtur seancën përgatitore në prezencën e përfaqësuesit të palës së paditur B.Z., ndërsa për palën paditëse nuk ka prezentuar askush.

Gjykata konstatoj se padia e parashtruar në gjykatë me datë 21.10.2020 nuk mban nënshkrimin e palës paditëse, andaj me procesverbal mori aktvendim me të cilin ndërpreu procedurën dhe e ktheu në plotësim padinë e paditësit B.M.Z. ku detyroj paditësin që brenda 8 ditëve pas mbajtjes së

seancës ta kthej padinë e plotësuar me nënshkrimin e palës. Aktvendimi ne procesverbal paditësi e ka pranuar me date 07.05.2024.

Pas kalimit të afatit ligjore, gjykata konstatoj se pala paditëse nuk i ka kryer veprimet procedurale si në aktvendimin e datës 29.04.2024.

Bazuar ne Ligjit për Konfliktet Administrative, nenit 33 nenit 33, Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që: *brenda afatit prej tetë (8) ditëve t'i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, dhe Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.*

Andaj, gjykata konsideron se nuk ka kushte për shqyrtimin e mëtejshëm të padisë, dhe vendosi si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.438/22, datë 27.05.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.